



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/21
Datë: 02.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Përcaktimin e Procedurave për Shkatërrimin e Strukturave të Paligjshme.
2. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/21
Datë: 02.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafit 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafi 3 dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet Nr. 04/L-111 dhe 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 paragrafin 2.4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohet Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore Kompania Rajonale e Ujësjiellit "Prishtina" Sh.A.
2. Emërohet Bordi i Përkohshëm i ndërmarrjes nga pika 1 me këtë përbërje:
 - 2.1. Mentor Hyseni, kryesues dhe drejtor;
 - 2.2. Hajrije Morina, drejtoreshë;
 - 2.3. Seat Bilibani, drejtor, dhe
 - 2.4. Idriz Maliqi, drejtor.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Për arsyet e cekura në memorandumimin shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrjes dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes KRU "Prishtina" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/21
Datë: 02.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafit 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 19 paragrafi 3 dhe nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet Nr. 04/L-111 dhe 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 paragrafin 2.4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Shkarkohet** Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Posta e Kosovës" Sh.A.
2. Emërohet Bordi i Përkohshëm i ndërmarrjes nga pika 1 me këtë përbërje:
 - 2.1. Mentor Arifaj, kryesues dhe drejtor;
 - 2.2. Kujtim Shala, drejtor;
 - 2.3. Sajmie Thaçi, drejtoreshë, dhe
 - 2.4. Blerton Abazi, drejtor.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Për arsyet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "Posta e Kosovës" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/21
Datë: 02.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafit 9 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 43 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet nr. 04/L-111 dhe 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 paragrafin 2.4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Ndërmarrjes Publike Qendrore "Hekurudhat e Kosovës - Infrakos" Sh.A. me këtë përbërje:
 - 1.1. Enis Berisha, kryesues dhe drejtor;
 - 1.2. Vjollca Jashari, drejtore;
 - 1.3. Artan Dermaku, drejtor, dhe
 - 1.4. Abdullah Lala, drejtor.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "Infrakos" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/21
Datë: 02.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike për përjashtim nga fushëveprimi i Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, për shërbimet telekomunikuese që ofron "Telekomi i Kosovës Sh.A", si shërbime me rëndësi të veçantë shtetërore, në harmoni me nenin 3.1 dhe 9.4 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.
2. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike - ASHI dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/21
Datë: 02.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L - 052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Ndihmë të Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë që të zhvillon negociata me Qeverinë e Konfederatës së Zvicrës me qëllim të finalizimit të tekstit përfundimtar të marrëveshjes së lartëcekur, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/21
Datë: 02.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L - 052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për Anëtarësim të Republikës së Kosovës në "Fondin për mbështetje kulturore të Këshillit të Evropës EUROIMAGES".
2. Obligohet Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit që të zhvillojë të gjitha procedurat për Anëtarësim të Republikës së Kosovës në "Fondin për mbështetje kulturore të Këshillit të Evropës EUROIMAGES" duke u bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/21
Datë: 02.04.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit Nr. 02/102, të datës 07.05. 2019, lidhur me Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të Ish të Dënuarve dhe të ish të Përndjekurve Politikë

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 02/102, i datës 7 maj 2019, kështuqë në vend të ish deputetit z. Sami Kurteshi, caktohet deputeti z. Artan Abrashi, nga Kuvendi i Kosovës, gjegjësisht Komisioni Përkatës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/21
Datë: 02.04.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 prill 2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Pakoja Mbështetëse për realizimin e mësimin në distancë, si në vijim:
 - 1.1. Sigurimi i shtesës mbi pagë për mësimdhënësit, të cilët janë drejtpërdrejtë të përfshirë në përgatitjen dhe prodhimin e video-materialeve mësimore për klasat 1-9;
 - 1.2. Sigurimi i shtesës mbi pagë për personelin e SHFMU "Qamil Batalli" në Prishtinë dhe SHFMU "Emin Duraku" në Prizren, të cilët janë të angazhuar drejtpërdrejtë në realizimin e mësimin në distancë;
 - 1.3. Sigurimi i shtesës mbi pagë për personelin civil mbështetës të DKA-së së Komunës së Prishtinës, DKA-së së Komunës së Prizrenit dhe të MASHTI-t, të cilët janë të angazhuar drejtpërdrejt në realizimin e mësimin në distancë.
2. Shuma e kompensimit mbi pagë e personave të angazhuar të përmendur në paragrafin 1 të këtij vendimi është në vlerë prej njëqindpesëdhjetë euro (150.00 €) deri në treqind euro (300.00 €) në muaj, për muajt mars, prill dhe maj 2020.
3. Kriteret për vlerësimin dhe kategorizimin e nivelit të angazhimit të personave të përfshirë në realizimin e mësimin në distancë i cakton MASHTI.
4. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për sigurimin e mjeteve financiare.
5. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe Ministria e Financave dhe Transfereve për zbatimin e këtij vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë